



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije - Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, 20 shkurt 2015

Telegram ngushëllimi

I nderuar kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, z. Hivzi Islami,

Më lejoni që të shpreh ngushëllimet e mia më të thella për ndarjen nga jeta të akademikut Ruzhdi Pllana.

Ndarja nga jeta e akademikut Pllana nuk ishte humbje vetëm për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, por ishte një humbje e madhe për arsimin dhe shkencën në përgjithësi.

Duke qenë mësues dhe pedagog i palodhshëm, shkruer i teksteve shkollore dhe autor i shumë punimeve shkencore, akademik Ruzhdi Pllana ka siguruar vendin e merituar në historinë e arsimit dhe të shkencës në Kosovë.

Ju lutem që në emër të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe në emër timin, t'i pranoni ngushëllimet më të sinqerta.

Me respekt,
Arsim Bajrami - ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

